

## Vizitë në bibliotekë

### **Skenar për filmin e animuar „oferta nga biblioteka për të gjithë“ nga DVB**

1. I rrituri dhe i vogli hapin dyert e bibliotekës, hyjnë brenda dhe çuditen.
2. I rrituri: Ooo, shiko sa shumë libra dhe njerëz ka këtu!
3. I vogli: „Shiko shiko, aty përpara qënka bibliotekarja, me siguri do të na ndihmojë.“
4. Bibliotekarja: „Mirëseerdhët! Si mund t’ju ndihmoj?“
5. I rrituri: „Ja karta ime e identitetit. Ne duam të huazojmë diçka.“
6. Bibliotekarja regjistron të dhënat në kompjuter dhe hap kartën e bibliotekës.
  - a. Pastaj ia jep atë të rriturit.
7. Bibliotekarja: „Me këtë kartë mund të huazoni libra dhe media të tjera.“
8. I rrituri dhe i vogli zbulojnë bibliotekën:
9. Aty ka rafte plot me libra. Dhe njerëz që kërkojnë libra dhe i shfletojnë ata. Ka filma dhe CD.
10. I vogli: „Shiko, ky është filmi im i preferuar! Dua ta marr patjetër.“
11. Ata vazhdojnë rrugën dhe shikojnë dikë që është ulur në kolltuk dhe lexon gazetën. Pastaj zbulojnë dikë që kërkon informacione në internet.
12. Këtu dikush u lexon fëmijëve një histori. Fëmijët dëgjojnë me vëmendje.
13. Më tutje nëpër tavolina njerëzit po lexojnë dhe shkruajnë.
14. I rrituri nuk e ka gjetur akoma librin që kërkon.
15. I rrituri: „Hajde!“
16. I drejtohet bibliotekarit që ka hipur në shkallë.
17. I rrituri: „Nuk di ku mund ta gjej këtë libër.“
18. Bibliotekari: „Ejani me mua.“

19. Ata kalojnë nëpër rafte derisa e gjejnë librin.
20. Bibliotekari: „Ju lutem! Këtu është libri që po kërkoni.“
21. I rrituri: „Ju faleminderit!“
22. Të dy shkojnë te banaku dhe vendosin librin, filmin dhe kartën e bibliotekës në të. Bibliotekarja ua huazon mediat. Pastaj ua kthen kartën. Dhe u shpjegon kur duhet t'i kthejnë mediat.
23. I rrituri dhe i vogli ikin. Së shpejti do të vijnë përsëri në bibliotekë!

Teksti: Bibliomedia Schweiz / Prill 2016  
Übersetzerin: Suela Jorgaqi Macek